

PROCESVERBAL
nga seanca e 44-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 05.12.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: dr. Metodija Jançeski.

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Arben Saiti, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 44-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:10 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota „pro“ miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur me datë 19.11.2024.
2. Kërkesë për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për transmetim televiziv e parashtruar nga SHTR TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë, me Propozim-Vendim.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike për SHTR TV EDO SHPKNJP fsh.Ljubin, Saraj për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike për SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike për SHTR TV-STAR SHPK Shtip, për shkelje të nenit 50, paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
6. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim me mall – central telefonik dhe telefoni fikse.

7. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim për blerjen e kartolinave për Vitin e Ri me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri me 5 vota „pro“ miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 43-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur me datë 19.11.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska, shpjegoi Kërkesën për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim televiziv, parashtruar nga SHTR TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë. Ajo tha se Kërkesa përfshin shtimin e programeve në gjuhën turke përveç shqipes. Për realizimin e këtij ndryshimi, është e nevojshme pëlqimi paraprak i Këshillit, në pajtim me dispozitat e Ligjit nga LSHMAAV neni 67, paragrafët 6 dhe 7, i cili përcakton se transmetuesi është i detyruar të zbatojë së paku 80% të konceptit programor për të cilën i është dhënë leja gjatë javës, por për ndryshimin ose plotësimin e 20% të konceptit programor duhet të merret paraprakisht pëlqimi i Agjencisë. Përndryshe, Televizioni KOHA në kërkesën e tij ka informuar se dëshiron të transmetojë emisione përveç se në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke, për të përmirësuar dhe pasuruar pluralizmin në raportimin për rajonin D8 ku transmeton programe, ku ka një numër të konsiderueshëm të popullsisë turke, dhe nuk ka medium që transmeton program në gjuhën turke. Janevska tha se propozimi është vlerësuar pozitivisht me arsyetimin se do të pasurojë peizazhin mediatik dhe do të promovojë shumëgjuhësinë. Dhe në këtë drejtim ajo propozoi që Këshilli të miratojë ndryshimin.

Z. Fidanoski deklaroi se do japë mbështetje, sepse një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komunitetit turk jetojnë në komunën e Gostivarit, komuna Vrapçisht, ku dhe gjuha turke është në përdorim zyrtar. Kjo është vetëm një tjetër mbështetje, pasurim dhe mundësi për forcimin e identitetit të tyre.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Kërkesën për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim televiziv të paraqitur nga SHTR TV KOHA Mevaip SHPKNJP Tetovë (nr.ynë.03-4934/1 datë 27.11.2024) dhe miratoi Vendim me të cilin jep pajtueshmëri për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-35 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA MEVAIP SHPKNJP Tetovë, në pjesën që ka të bëjë me gjuhën e transmetimit, gjegjësisht përveç transmetimit të programit në gjuhën shqipe, radiodifuzeri të transmeton program dhe në gjuhën turke.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipër ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV EDO SHPKNJP fsh. Ljubin, Saraj për shkëlje të nenit 92, paragrafi (1) të

LSHMAAV. Ajo shpjegoi se mbikëqyrja është realizuar në tetor dhe bëhet fjalë për moszbatim të detyrimit për transmetim së paku 30% të veprave audiovizuele maqedonase, sepse në ditën e analizuar televizioni ka transmetuar 27%, që është për 37 minuta dhe 55 sekonda më pak se sa kërkohet. Propozohet vërejtje publike me afat prej 20 ditësh për harmonizim, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4547/1 datë 04.11.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV EDO SHPKNJP fsh.Ljubin, Saraj, t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 3 tetor 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga pranimit i Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KTV SHPKNJP Kavadar, për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se nga mbikëqyrja është konstatuar se radiodifuzeri ka transmetuar përmbajtje në gjuhën kroate, angleze dhe serbe pa përkthim në gjuhën maqedonase, që është në kundërshtim me rregullativat. Është propozuar vërejtje publike me afat prej 10 ditësh për harmonizim, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje plotësuere.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4545/1 datë 04.11.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR KTV SHPKNJP Kavadar t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 3 tetor 2024 disa përmbajtje programore janë transmetuar pjesë të fjalës(bisedës) në gjuhë të huaja (kroatish, ose anglisht, ose sërabisht), pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga neni 64, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV-STAR SHPK Shtip, për shkelle të nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur. Ajo shpjegoi se shkella tek televizioni Star nga Shtipi është përcaktuar nga mbikëqyrja e rregullt në tetor dhe i referohet aplikimit të gabuar të sinjalistikës paralajmëruese për programet e kategorisë së dytë, siç janë serialet „Klasa 406 (Klasot 406)“ dhe „Derisa fshati flen (Dodeka seloto spie)“. Kjo është në kundërshtim të nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat prej 20 ditësh për harmonizim, dhe më pas të kryehet mbikëqyrje kontrolli për verifikim të respektimit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4564/1 datë 05.11.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV-STAR EDO Shtip t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelle të nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, për shkak se më 3 tetor 2024 episodet reprizë dhe premierë të serialeve artistike „Klasa 406 (Klasot 406)“ dhe „Derisa fshati flen (Dodeka selo spie)“ janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalistikës paralajmëruese për programet e kategorisë së dytë (8+), përkatësisht:

- Para fillimit të transmetimit, nga tërësia e paraqitjes së parashikuar me ligj të aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungonin: numri „8“; shenja „+“, dhe teksti i shkruar dhe i lexuar i paralajmërimit, si tregues i grupmoshës së shikuesve për të cilin është destinuar programi, dhe
- Numri „8“ dhe shenja „+“ mungonin dhe në sinjalizimin e zbatuar në vazhdimësi gjatë episodeve të transmetuara.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme mr.Arben Saiti shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të mallit – central telefonik dhe telefonisë fikse. Ai shpjegoi se propozohet furnizimi me central të ri telefonik dhe telefonisë fikse për Agjencinë, sepse pajisja ekzistuese është teknologjikisht e vjetëruar dhe shpeshherë shkaktojnë probleme. Centrali është rreth 10 vjet, ndërsa telefoni fiks që përdor sekretaria (e punës)afariste është jashtë funksionit për shkak të difekti mekanik. Propozimi është zëvendësimi i pajisjeve për të përmirësuar komunikimin.

Kryetari Petrushevski komentoi se furnizimi është i natyrës teknike, duke theksuar se nuk kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme, por nën 1.000 euro, që do të thotë se nuk është i nevojshëm zbatimi për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim të mallrave – central telefonik dhe telefoni fikse me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, në shumë prej 54.500,00 denarë pa TVSH, gjegjësisht gjithsej në shumë prej 64.310,00 denarë me TVSH.

Mjetet e mësipërme sigurohen nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 7

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizimin me kartolina për Vitin e Ri me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ai shpjegoi se do të blihen 200 urime për Vitin e Ri, të ndara në dy kategori me çmime të ndryshme, nga firmë që ofron çmim më të ulët. Përzgjedhja tashmë është kryer nga tre oferta, që është praktikë standarte dhe furnizim çdo të dytin vit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin për marrjen e vendimit për furnizimin e kartolinave të Vitit të Ri për nevojat e Agjencisë me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, e cila nuk do të kalojë shumën prej 12.000,00 pa TVSH të llogaritur.

Mjetet e mësipërme sigurohen nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim, nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**